

Vendim nr. 125 datë 13.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Marjana Semini, Anëtare
Sandër Beci, Anëtar

në datën 13.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (S) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SABRI HOXHA**

OBJEKTI: **Kundërshtimi dhe kërkimi i interpretimit ligjor të vendimeve nr. 1164, datë 24.11.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 527 të regjistrit themeltar, datë 26.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 116, 120, 121, 132, 134, pika 1, shkronja “i”, 140, pikat 2, shkronja “a” dhe 3, shkronja “b”, 142, 143, 145 dhe 146 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Sabri Hoxha ka ushtruar detyrën e ekspertit mjeko-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore (*IML*) për periudhën 2008 – 2014. IML-ja ka depozituar kallëzim penal ndaj kërkuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi ka pretenduar se në

tre akte të përpiluara prej tij, në cilësinë e ekspertit mjeko-ligjor, ka vendosur titullin “profesor doktor”, të cilin nuk e dispononte dhe nuk e gëzonte.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka shpallur moskompetencën dhe ia ka kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit ka regjistruar procedimin penal nr. 8197, datë 11.11.2021, në ngarkim të kërkuesit, për kryerjen e veprës penale “Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore”, të parashikuar nga neni 246, paragrafi i parë, i Kodit Penal (KP).

3. Për nevoja të hetimit, prokuroria ka administruar nga IML-ja aktet e ekspertimit, për të cilat është paraqitur kallëzimi, përfshirë edhe korrespondencën e këtij institucioni me Universitetin e Mjekësisë Tiranë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë (MASR), sipas të cilave kërkuesit nuk i ishte dhënë titull akademik “profesor” ose “profesor i asociuar” dhe se në regjistrin e doktoraturave dhe titujve të njësuar në Republikën e Shqipërisë që nga viti 2009 nuk rezultonte ndonjë titull akademik i njësuar në emër të tij. Sipas MASR-së, kërkuesit nuk i është njohur titulli i dhënë nga një kolegji privat në Kosovë, me arsyetimin se titujt e fituar në universitetet private nuk kanë vlerë kombëtare, por mund të transferohen vetëm brenda institucioneve arsimore private në bazë të vendimmarrjes së universitetit pritës.

4. Në përfundim të hetimit, prokurori ka konkluduar se dispozita penale e atribuar në rastin konkret e parashikonte faktin si kundërvajtje penale dhe duke qenë se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ai ndodhej para rrethanave për pushimin e procedimit penal, sipas nenit 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Ky vendim është kundërshtuar nga IML-ja.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 26.04.2022, ka vendosur pranimin të kërkesës së ankuesit dhe kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar atë që të formulojë akuzën për veprën penale “Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore”, të parashikuar nga neni 246, paragrafi i parë, i KP-së, ndaj kërkuesit, si dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes. Gjykata ka çmuar se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim prokuroria dhe kërkuesi.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1164, datë 24.11.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se vendimi është marrë në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material penal, si dhe të provave të marra dhe të shqyrtuara në atë gjykim. Sipas gjykatës, prokurori duhet të hetojë në lidhje me faktin nëse kërkuesi është caktuar nga gjykata si ekspert mjeko-ligjor për njohuri të posaçme që lidhen me ekzistencën e titullit “profesor” të ekspertit, si dhe të hetojë nëse përvetësimi i titullit “profesor”, i shoqëruar me kryerjen e veprimeve që i takojnë mbajtësit të titullit, kryerjen

e akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, sipas detyrave të lëna nga gjykata, është kryer për qëllime fitimi, pasi në një rast të tillë do të gjendej përpara nenit 246, paragrafi i dytë, të KP-së. Në paragrafin e dytë të dispozitivit të këtij vendimi është pasqyruar urdhërimi se kundër tij lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit.

7. Në datën 14.04.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar dhe kërkuar interpretimin ligjor të vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjykatat kanë cenuar:
- 8.1. *Liritë dhe të drejtat* e parashikuara në nenet 4, 5, 15, pika 1, 16, 17, 18, 20, 23, 25, 29, 31, 33, 42, 116, 121, 122, 142 dhe 148 të Kushtetutës, kanë konsumuar në bashkëpunim veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 245/1, 250, 252, 287, 300 dhe 302 të KP-së, si dhe kanë shkelur nenet 59, 19, 11/1, 10, 6, 5/2, 294 dhe 321 të KPP-së.
- 8.2. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të standardit të arsyetimit të vendimit, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë ka mungesë logjike, është i paargumentuar dhe e ka kryer analizën qëllimisht në mënyrë të gabuar. Po kështu, ato në rastin e tij kanë vepruar me standard të dyfishtë.
- 8.3. *Pavarësinë e prokurorisë*, të garantuar nga neni 148 i Kushtetutës, pasi kanë ushtruar ndikim të paligjshëm ndaj këtij organi, me qëllim që ai të dëmtojë faktet dhe provat, si dhe të shkelë nenet 121 dhe 122 të Kushtetutës.
- 8.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi ato janë diskriminuese, persekutuese të ekspertëve që demaskojnë krimin dhe pastruese të produkteve të veprave penale të shkaktuara nga kallëzuesi shpifës, drejtuesi i IML-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuetit

9. Çështja e legjitimitetit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin

përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështirësi, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

11. Kolegji vlerëson se kërkuuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, parimit të barazisë përpara ligjit, pavarësisë së prokurorisë, si dhe të lirive dhe të drejtave të tjera kushtetuese, të parashikuara në nenet 4, 5, 15, pika 1, 16, 17, 18, 20, 23, 25, 29, 31, 33, 42, 116, 121, 122, 142 dhe 148 të Kushtetutës.

Ndërkohë, vendimet e kundërshtuara, pra ai i shkallës së parë dhe i apelit, jo vetëm që nuk janë përfundimtare, pasi kundër tyre është ushtruar rekurs, por ato as nuk e zgjidhin në themel çështjen e kërkuarit lidhur me fajësinë ose pafajësinë e tij. Në këto kushte, ato nuk mund të konsiderohen përfundimtare për efekt të gjyimit kushtetues. Për rrjedhojë, kërkuari nuk ka shteruar ende të gjitha mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion në formë e substancë, prandaj nuk mund të vërë në lëvizje gjyimin kushtetues.

14. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se kërkitimi i kërkuarit për interpretimin e vendimeve të disponuara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, objekt ankimi, nuk hyn në juridiksionin kushtetues, ndaj ai nuk do të merret në shqyrtim.

15. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.